



**REPUBLIKA E SHQIPERISE  
PROKURORI I PËRGJITHSHËM**

**URDHËZIM  
NR.3 DATË 09.12. 2003**

**PËR  
USHTRIMIN E TE DREJTES SE ANKIMIT NGA PROKURORI**

***Me synim,***

- për të garantuar ushtrimin e unifikuar, në përputhje me dispozitat ligjore, të së drejtës së ankimit nga prokurori;
- për të shmangur praktikat e gabuara në nivele të ndryshme të Prokurorive, si dhe;
- për të permirësuar nivelin cilësor të shqyrtimit dhe përkrahjes së ankimeve të prokurorëve të të gjithë niveleve;

***Mbështetur,*** në nenin 24 pika 4 e vijues të K. Pr. Pehale dhe nenin 8 pika 2 të ligjit Nr. 8737 datë 12. 02. 2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë së Republikës së Shqipërisë",

**U D H Ë Z O J:**

**I. USHTRIMII TË DREJTËS SË AHKTIMIT NGA PROKURORI**

1. Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës të shkallës së parë, prokurori pranë Gjykatës së Apelit, prokurori i seancës dhe prokurori i Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm, janë subjektet që u njihet e drejta e ankimit kundër vendimeve të gjykatës.
  - 1.1. Për të mundësuar ushtrimin e kësaj të drejte, prokurori i seancës, në përfundim të gjykimit, menjëherë, duhet të informojë drejtuesin e Prokurorisë, për kërkesën e tij dhe vendimin e gjykatës. Në kdpjeri e aktit të konkluzioneve përfundimtare të prokurorit shënohet e drejta e dispozitivit të vendimit gjyqësor penal.
  2. Prokurori i seancës bën ankim, në rastet kur, megjithëse ekzistojnë shkaqe ligjore, e drejta e ankimit nuk ushtrohet nga drejtuesi i Prokurorisë.
  3. Drejtuesit e Prokurorisë dhe prokurorët e seancës, sipas niveleve, duhet të jehë të vemëndëshëm për të ushtruar të drejtën e ankimit në të gjitha rag-tet e përcaktuara me ligj.
  4. Apëlim kundër vendimeve të Gjykatës të shkallës së parë, si rregull duhet të ushtrohet në rastet:
    - 4.1. kur është vendosur pafajësi, pushim çështje dhe/ose akuze, ndryshim i

cilësimit juridik për një vepër më të lehtë se akuza e ngritur rij-ja prokurori, për ulje të dënimit nën kufijtë e parashikuar nga ligji pa shkaqe ligjore, për pezullim të ekzekutimit të vendimit me burgim kur mungojnë shkaqet ligjore, për kthimih e akteve të" pa kërkuara nga prokurori, për Uojë e rnsa dënimi të vënddsufa pa u respektuar kriteret -ligjore mbi mënyrën e caktimit të dënimit dhe/ose kur ato janë dukshërh. më të buta se kërkesat e prokurorit, si dhe kur për kërkesat paraprëke gjykata nuk disponon me vendim të ndërmjetëm në momentin e ngritjes së kërkesës për mënyrën e zgjidhjes së saj;

- 4.2. kur është vendosur zbutja e masës së sigurimit të kërkuar nga prokurori ose është zëvendësuar masa e sigurimit nga gjykata me një tjetër më të lehtë, si dhe;
- 4.3. kur në kundërshtim me ligjin është vendosur, shtyrja e ekzekutimit të vendimit, lirimi me kusht, lirimi i të burgosurit ose revokimi i vendimit, në fazën e ekzekutimit të vendimeve penale.

5. Rekurs në Gjykatën e Lartë kundër vendimeve të formes së prerë të Gjykatave të Apeleve, si rregull duhet të ushtrohet ne rastet:

- 5.1. kur prishet vendimi i Gjykatës të shkallës së parë dhe vendoset pafajësi, pushim akuze dhe/ose ceshtje, ndryshim i cilësimit juridik për një vepër më të lehtë se akuza e ngritur nga prokurori ose për ulje të dënimit nën kufijtë e parashikuar nga ligji pa shkaqe ligjore, për pezullim të ekzekutimit të vendimit me burgim kur mungojnë shkaqet ligjore, për Uoje e masa dënimi të vendosura pa u respektuar kriteret ligjore mbi mënyrën e caktimit të dënimit dhe/ose kur ato janë dukshëm më të buta se kërkesat e prokurorit, si dhe kur për kërkesat paraprake gjykata nuk disponon me vendim të ndërmjetëm në momentin e ngritjes së kërkesës për mënyrën e zgjidhjes së saj;
- 5.2. kur shfuqizohen ose ndryshohen/zbuten masat e sigurimit personal ose lihet në fuqi vendimi i gjykatës i apeluar nga prokurori, si dhe;
- 5.3. kur në kundërshtim me ligjin, vendoset shtyrja e ekzekutimit të vendimit, lirimi me kusht, iirimi i të burgosurit ose revokimi i vendimit, në fazën e ekzekutimit të vendimeve penale.

6. Në rastet kur drejtuesi i Prokurorisë ose prokurori i seancës, çmojnë për të mos ankimuar (apeluar ose rekursuar) kundër vendimit të gjykatës, për **shkaqet** e përmendura në **pikat 4 e 5 të këtij udhëzimi**, brenda afatit ligjor të ankimit, ato duhet të njoftojnë, përkatësisht, drejtuesii e Prokurorisë së Apelit që i ka në juridiksion ose drejtorin e Drejtorisë Gjyqësore të kësaj Zyre, të cilët vlerësojnë dhe vendosin lidhur me ushtrimin ose jo të ankimit (apelimit ose rekursit).

- 6.1. Në rastet kur është e mundur, çështja analizohet nën drejtimiri, përkatësisht, të drejtuesit të Prokurorisë së Apelit ose drejtorit të Drejtorisë Gjyqësore dhe me pjesërnarrjen, sipas rastit, të prokurorit të seancës, të drejtuesit përkatës të Prokurorisë ose të drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit.

7. Në rastet kur apelimi është bërë nga i pandehuri ose mbrojtësi i tij, drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës të shkallës së parë ose prokurori i seancës, me marrjen e njoftimit për apelimin, mbrenda afateve ligjore të bëjnë apel kundërshtues, duke arsyetuar kundërshtimin e shkaqeve të parashtruara në apelimin e tyre.
8. Në rastet kur drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës të shkallës së parë ose prokurori i seancës ose drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit bëjnë ankim (apelim ose rëkurs) ose apel kundërshtues, një kopje e apelit, apelit kundërshtues ose rekursit i dërgohet menjëherë Prokurorisë pranë Gjykatës që do të shqyrtojë ankimin.
9. Prokurori pranë Gjykatës së Apelit dhe/ose prokurori i Prokurorisë së Përgjithshme, kur e çmojnë të nevojshëm, për të arsyetuar me\* mire pikat e vendimit që kundërshtohet, shkaqet e ankimit dhe çfarë kërkohet, duhet të bëjnë ankim plotësues pavarësisht nga ankimi ose mendimi, përkatësisht, i prokurorit të seancës apo i drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës të shkallës së parë dhe/ose atij të Apelit.

## **II CAKTIMI I ÇËSHTJEVE, PËRFAQËSIMI DHE PËRKRAHJA E ANKIMIT TË PROKURORIT MGA PROKURORI MË I LARTË**

1. Në Prokuroritë e Apeleve dhe në Drejtorinë Gjyqësore të kësaj Zyre, caktimi i çështjeve, si rregull, bëhet mbi bazën e shortit të hapur, në prani të prokurorëve, i cili organizohet një herë në\* javë, përkatësisht, nga kryesekretari i Prokurorisë të Apeleve dhe Shefi i Kabinetit i kësaj Zyre, duke bërë dhe dokumentacionin e këtij procesi. Organizimi dhe dokumentimi i shortit:
  - 1.1. Në Prokuroritë e Apeleve bëhet nën kontrollin dhe mbikëqyrjen e drejtuesit të Prokurorisë së Apelit përkatës, ndërsa;
  - 1.2. Në Drejtorinë Gjyqësore të kësaj Zyre bëhet nën kontrollin dhe mbikëqyrjen e drejtuesit të Drejtorisë Gjyqësore.
  - 1.3. Përjashtimi nga ky rregull duhet të jetë i motivuar.
2. Prokurori më i lartë, duhet të bëjë të gjitha përpjekjet ligjore për të përkrahur apelimin, apelin kundërshtues ose rekursin e prokurorit, duke përfaqësuar me dinjitet dhe profesionalizëm mbrojtjen e akuzës të ngritur nga prokurori më i ulët ose masën e sigurimit personal të kërkuar prej tij.
3. Në rastet kur apelimi është bërë nga prokurori i seancës dhe prokurorise drejtuesi i Apelit ka vlerësim të ndryshëm me apelimin e tij, me kërkesën e prokurorit të seancës dhe me autorizim të drejtuesit të Prokurorisë së Apelit, prokurori që ka bërë apelimin përfaqëson çështjen në Gjykatën e Apelit.
  - 3.1. Drejtuesi ose prokurori i Prokurorisë së Apelit, vlerësimin ndryshe rdaj apelit të prokurorit të seancës duhet ta bëjë të arsyetuar, në formën e një relacioni, duke parashtruar shkaqet ligjore të mospërfaqësimit të apelit prej tij. Relacioni i bashkëlidhet autorizimit që arshivohet në Prokurorinë e Apelit.

4. Heqja dorë nga ankimi i prokurorit më të ulët dhe/ose mospërkrahja e apelimit, apelit kundërshtues ose rekursit të tij, në çdo fazë të shqyrtimit të tij, duhet të jenë të motivuara dhe mund të bëhen vetëm pasi çështja të analizohet me drejtuesin e Prokurorisë dhe/ose prokurorin e seancës qëlca bërë apelimin, apelin kundërshtues ose rekursin.
  - 4.1. Prokurori më i ulët ka të drejtë të ankohet për heqjen dorë ose mospërkrahjen e apelimit, apelit kundërshtues ose rekursit të tij, perkatesisht tek drejtori i drejtorise gjyqesore te kesaj zyre ose tek Prokurori i Pergjithshem.
  - 4.2. Nëse nga studimi osë analiza e çështjes së ankimuar nga prokurori del që prokurori i apelit nuk mund të përkrahe apelimin apo apelin kundërshtues dhe drejtuesi i prokurorisë ose prokurori i seances nuk e mbeshtesin apelimin apo apelin e kundërshtues te tyre, prokurori i apelit duhet te arsyetoje me shkrim deklarimin e heqjes dore dhe/ose te mosperkrahes se ankimit te prokurorit me te ulet, te kunderfirmuar nga drejtuesi i Prokurorisë se apelit, si dhe te njoftoje, menjehere Drejtorine Gjyqesore te kesaj zyre duke parashtruar shkeljet ligjore te lejuara nga prokurori pergjegjes, qe kane ndikuar ne mosperkrahen e apelimit ose apelit kundërshtues.
5. Prokurorët sipas shkallëve të gjykimit, pas shqyrtimit të apelimit në Gjykatën e Apelit ose të rekursit në Kolegjin Penal ose Kolegjet e Bashkuara në Gjykatën e Lartë, duhet të njoftojnë prokuroritë e interesuara për mënyrën e përfundimit të apelimit, apelimit kundërshtues ose rekursit dhe sipas rastit të bëjnë dhe vërejtje, për konstatime lidhur me shkelje të ligjës, duke informuar për shkeljet edhe Drejtorinë e Persdnelit dhe Inspektimit të kësaj Zyre.

### **III. ZBATIMI DHE PËRGJEGJËSIA PËR SHKELJET**

1. Me këtë udhëzirn të njihen prokurorët dhe drejtuesit e Prokurive të të gjithë niveleve.
2. Për të ndjekur dhe kontrolluar zbatimin e këtij udhëzimi ngarkoheri' prokurorët dtie drejtuesit e Prokurorisë të të gjitha niveleve, Drejtoria Gjyqesore dhe strukturat e tjera të kësaj Zyre.
3. Mospërrnbushja e detyrave të përcaktuara në këtë udhëzim, përbën shkelje të disiplinës në pune, neni 32 gërma "b" e ligjit "Për Qrganizimin dtie funksionimin e Prokurorisë në Repubhkën e Shqipërisë", etj.

### **IV. HYRJA NË FUQI**

1. Urdhërat Nr. 132 datë 20, 11. 1998 dhe Nr. 11 datë 6. 03. 2000, si dhe çdo akt tjetër normativ i kësaj Zyre qe bie në kundërshtim me kërkesat e ketij udhëzimi, shfuqizohen.
2. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

**PROKURORI I PERGJITHSHEM**

**THEODHORI SOLLAKU**